



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:137187

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05547623

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.. G.. për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.2701/23 të datës 15.06.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.04.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës e lidhur në mesë të pandehurit G.. G.. dhe të dëmtuarit Sh.. (R..) S.. nga fsh R.. K.. P..

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II-nr.2701/23 të datës 15.06.2023.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit: **G.. G..**, i lindur me datë, në fshatin Z.. K.. P.., i atësisë S.., dhe amësisë F.., e vajzërisë D.., me vendbanim në rr“Sh.. N..“ fshati Z.. K.. P.., i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., posedon numër telefoni, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 15.06.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.701/23 ndaj të pandehurit G.. G.. për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 29.03.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit G.. G.. dhe të dëmtuarit Sh.. (R..) S.. nga fsh R.. K.. P.., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës e lidhur në mesë të pandehurit G.. G.. dhe të dëmtuarit Sh... (R...) S... nga fsh R.. K.. P..

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2023:137187, 04.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

Gj y q t a r i

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.